



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministririt
Kabinet Ministra
Minister's Office

REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT / MINISTARSTVO KULTURE, YOUTH AND SPORTS	
Nr. Njes. <i>CE</i>	Shenja klas. <i>96</i>
Nr. Prot/Viti <i>91/2024</i>	
Data <i>10.01.2024</i>	
Nenshkrimi <i>[Signature]</i>	Prishtine

Nr.03/2024

Data:10.01.2024

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/14 -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh neni 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), bazuar në Rregulloren (QRK) NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-088 për Trashëgimi Kulturorë, Rregulloren NR.11/2022 Për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi me numër të protokollit 72/2024 i datës 10.01.2024 i Komisionit Profesional Shqyrtues i kërkesave, propozimeve të reja për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme, aseteve apo përmbajtjeve me forma të shprehjes kulturorë - për përfshirjen e asetit “Shtëpia e Rexhep Malës” në Kategorinë e Trashëgimisë Kulturorë Arkitekturale.
2. Obligohet QRK- Gjilan që asetin sipas pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi ta regjistrojë në databazë, t'i japë numrin unik, ta kategorizojë sipas Ligjit në fuqi dhe ta përfshijë në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme, në kategorinë e Trashëgimisë Arkitekturale.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Profesional Shqyrtues në kuadër të DTK-së është takuar më datë 09.01.2024 për të shqyrtuar propozimin për mbrojtje të përkohshme të titulluar “Shtëpia e Rexhep Malës” si aset me potencial në kategorinë e trashëgimisë kulturore arkitekturale. QRTK Gjilan e ka përgatitur propozimin dhe formularin e inventarizimit, të cilin më pas e ka dërguar në Komisionin Profesional Shqyrtues të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve - IKMM si institucion kompetent për kategorinë arkitekturale. IKMM pas shqyrtimit e ka sjellë rekomandimin për aprovim për kategorizimin e këtij aseti në kategorinë e Trashëgimisë Kulturore Arkitekturale.

Komisioni Profesional Shqyrtues në kuadër të DTK-së e ka analizuar propozimin si dhe dokumentacionin shtesë, dhe e ka rekomanduar Ministrin e MKRS-së që ta listojë për mbrojtje të përkohshme asetin “Shtëpia e Rexhep Malës” në kategorinë e Trashëgimisë Kulturore Arkitekturale, për arsye se i përmban këto vlera:

Vlera historike, shoqërore dhe shpirtërore:

Rexhep Mala është një ndër figurat më të ndritura të ilegales shqiptare. Ai punoi për lirinë e viseve shqiptare, të cilat ndodheshin nën Jugosllavi. Veprimtaria shoqërore atdhetare e cila ishte përcjellë brez pas brezi në familjen Malaj, ka ndikuar që Rexhep Malaj të angazhohej në luftën për liri, ku 11 Janari i vitit 1984 e ndezi flakën e lirisë nga “Kodra e trimave” të Prishtinës.

Rexhep Mala u lind në Hogosht të Dardanës (ish-Kamenicë) më 29 mars të vitit 1951. Ishte djali i babë Mehmetit dhe nënë Fahrijes. Ka prejardhje nga një familje tradicionale e atdhedashëse. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, në Hogosht, ndërsa më pas është shpërngulur me familjen në Gjilan, ku është regjistruar në gjimnazin “Zenel Hajdini”. Edhe pse i ri në moshë ka marrë pjesë aktive në demonstratat e nëntorit të vitit 1968, kur ishin paraqitur kërkesa për më shumë liri qytetare dhe avancim të pozitës kushtetuese të Kosovës.

Rexhep Mala është njëri ndër idealistët dhe formuluesit e idesë shtetërore. Vepra patriotike e Rexhep Malës u pasqyrua në shkrime librash, emra rrugësh, sheshe, uzina, emërtime shkollash e institucioneve shtetërore e komunale, në ngjarje kulturore, etj.

Veshjet, shkrimet, fotot, librat, artikujt, hartat, e armët e ndërlydhura me Rexhep Malën janë vlerë e shtuar e shtëpisë së tij që do të listohet në mbrojtje të përkohshme.

Literatura ku flitet për Idealin dhe atdhetarinë e Rexhep Malës është:

- Basri Musmurati “Qëndrestarët “Rexhep Malaj-Nuhi Berisha”, Prishtinë, 2011;
- Selatin Novosella “Rexhep Mala, Anteu i lëvizjes ilegale” , Prishtinë, 2007;
- Kadri Zeka “Vepra” Liria, 1986;
- Rexhep Malaj “Qëndresa”, Gjilan, 2002.

Shtëpia e Rexhep Malës ndodhet afër Atik Xhamisë, në rrugën “Abdullah Presheva” në zonën e vjetër të qytetit të Gjilanit që dikur quhej mëhalla e Xhamisë së vjetër. Ndërsa për tek shtëpia shkohet nga një rrugicë e ngushtë, në fund të së cilës shfaqet oborri i gjerë i shtëpisë së tij. Shtëpia e heroit kombëtar,

ka arkitekturë të thjeshtë, etazhitet S+P+1, kulm të pjerrët. Dyert dhe dritaret i ka nga druri. Ka vija të drejta, forma katrore pa ndonjë simetri të dukshme. Nuk ka dekore të theksuara në fasadë dhe nuk posedon vlera arkitekturale. Shtëpia është e ndërlidhur me jetën e heroit Rexhep Mala dhe veprimtarinë e tij, prandaj shquhet për vlerat historike, shoqërore dhe shpirtërore.

Rexhepi u ngrit si intelektual atdhetar në atë shtëpi, u formësua politikisht, në të u përgatit edhe shpirtërisht për qëndresë. Në atë shtëpi priti e përcolli shokë të idealit, e në atë shtëpi vendosi për veten e tij: do të binte po nuk do të dorëzohej.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK-së pas shqyrtimit të lëndës, dhe tërë dokumentacionit shtesë, e ka rekomanduar për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme në kategorinë e trashëgimisë arkitekturale.

Vendimi i dërgohet:

Kabinetit të Ministrit;

Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm

Komisionit Shqyrtues;

Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;

QRTK- Gjilan;

Muzeut Kombëtar të Kosovës;

Departamentit Ligjor;

Arkivit të MKRS- së.



Hajrulla Çeku
Ministër